



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

NR:08-158
20.05.2025
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ Të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-158 datë 07.05.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-158 datë 16.05.2025, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-2125/3 datë 20.05.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 21-të mbajtur më 19.05.2025 miratoi:

AKTVENDIM
për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim televiziv

NDËRPRITET procedura e inicuar për heqje e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 19-të mbajtur më 08.05.2025, me Konkluzionin ark.nr.02-1997/6 datë 08.05.2025, miratoi propozimin e Dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-158 datë 07.05.2025 dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-2030/1 datë 07.05.2025, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 08.05.2025, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-158 datë 08.05.2025, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

**ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија**

Тел. + 389 2 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk**



¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Megjithatë, më 15.05.2025 drejtuar mr.Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga Drejtori i Agjencisë, është dorëzuar Njoftimi me nr.ark.05-2030/2 datë 15.05.2025, se SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, me datë 06.05.2025 ka kryer pagesë në shumë prej 300.000,00 (treqind mijë) denarë, me datë 08.05.2025 ka kryer pagesë në shumë prej 255.000,00 (dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë) denarë, me datë 09.05.2025 ka kryer pagesë në shumë prej 1.155.000,00 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) denarë dhe me datë 14.05.2025 ka kryer pagesë në shumë prej 2.028.517,00 (dy milion e dyqind e tetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) denarë, me të cilin transmetuesi kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar plotësisht.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10² të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-158 datë 07.05.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-158 datë 16.05.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2125/3 datë 20.05.2025, Këshilli i Agjencisë në seancën e 21-të mbajtur më 19.05.2025, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

² Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).